



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 29.05.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kerkesës për rishqyrtim të datës 28.05.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "NPT El Dreni" për aktivitetin :"**Furnizimi me material elektrik, material hidrosanitar, material te bravarise, vegla dhe rroba pune per nevojat e Komunes se Prishtines - LOT 1**" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-1070-121 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet ankesa e Operatorit Ekonomik "NPT El Dreni" e datës 28.05.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Furnizimi me material elektrik, material hidrosanitar, material te bravarise, vegla dhe rroba pune per nevojat e Komunes se Prishtines - LOT 1**", me Nr.616 19 020 121, kundër Njoftimit për Vendimin e AK-së, të datës 22.05.2019, të publikuar në E Prokurim;
2. Vërtetohet Vendimi i AK i publikuar me datë: 22.05.2019;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj aktivitetin sipas publikimit.*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "El Dreni" me datë 28.05.2019 ka parashtruar kerkesën për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizimi me material elektrik, material hidrosanitar, material te bravarise, vegla dhe rroba pune per nevojat e Komunes se Prishtines - LOT 1**

Autoriteti Kontraktues, me datë 29.05.2019, ka shqyrtuar ankesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet ankimore të tenderuesit:

-Tenderuesi në bazë të njoftimit për Vendimin e AK-së ka shprehur mospajtimin e tij lidhur me rezultatet e njoftimit të Vendimit të AK të datës 22.05.2019 por ka dorëzuar kërkesën e tij pas afatit të parapare ligjor dhe për këto pretendimet e tij nuk mund të shqyrtohen.

Bazuar në faktin se Autoriteti Kontraktues ka pranuar kërkesën për rishqyrtim pas afatit të parapare ligjor, konstaton se e njëjta është e pa bazuar.

Nga konstatimet paraprake u vendos si në Dispozitiv të Vendimit.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit